

Ndërlidhja e inteligjencës emocionale dhe empatisë tek infermierët e Spitalit të Përgjithshëm të Gjakovës ndaj pacientit

Idrizi Fitim¹; Taganoviq Besarta¹

Kolegji Heimerer¹

Aftësia për të njohur ndjenjat tona dhe ato të të tjerëve, për të motivuar veten dhe për të menaxhuar emocionet mire në vetveten dhe në marrë dhëniet tona (Goleman, 1999). Empatia është aftësia për të marrë pjesë në mënyrë të përhershme dhe për të kuptuar përvojën dhe emocione të të tjerëve (Ouzouni & Nakakis, 2012).

Qëllimi i këtij hulumtimi është të masim inteligjencën emocionale dhe ndikimin e saj për empatinë ndaj pacienti. Mostra e përzgjedhur për të e realizuar këtë hulumtim është 100 infermierë të Spitalit të Përgjithshëm “Isa Grezda” Gjakovë.

Instrumenti i cili është përdorur për hulumtimin e aftësive emaptike është pyetësori “The Empathy quotient (EQ)” i formuluar nga Autori Simon Baron-Cohen nga Universiteti i Cambridge. Ky pyetësor përmban 60 Pyetje. Instrumentit për matjen e inteligjencës emocionale është përdorur pyetësori “Messi Methodology” nga autorët Frankovsky & amp; Birkenerova, 2013. Pyetësori përmban 21 pyetje.

Rezultatet: Analiza korrelacionale me koeficientin e Pearson-it, u përdor për të përcaktuar marrëdhënien në midis inteligjencës emocionale dhe empatisë. Në bazë të analizës së korelacionit kemi parë se niveli i edukimit ka ndërlidhje pozitive statistikisht signifikante me inteligjencën emocionale. Në një analizë tjetër në mes variabilit të moshës dhe empatisë ekziston korelacion negativë statistikisht siginifikant. Nga kjo analizë rezulton që sa më e madhe të jetë moshë aq më e ulët është empatia.

Përfundimisht mund të konkludohet se studimi i shkathtësive dhe kompetencave emocionale në kontekste të ndryshme konsiderohet vlerë e shtuar dhe me një rëndësi të veçantë për jetën e individit në përgjithësi dhe sferat e saj.

Fjalët kyçe: Inteligjenca Emocionale, Empatia, Infermierë